



**BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Në bazë të Nenit 25 paragrafit 1 dhe 3 dhe 47, paragrafi 1 pika 20 e Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

**VENDIM  
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT PËR EMETIM TË  
KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 500 DENARË ME KARAKTERISTIKA  
THEMELORE TË NDRYSHUARA**

**(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 88/2020)**

1. Në Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 500 denarë me karakteristika themelore të ndryshuara („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 50/19) në pikën 2 shtohet një paragraf i ri 2 i cili thotë:

Ndryshohen karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominal 500 denarë të përshkruara në nën-pikën 2 g) të Vendimit për emetimin e strukturës nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 45/96) dhe pika 2 e Vendimit për emetimin dhe shtypjen e kartëmonedhave me vlera nominale 500 dhe 1000 denarë me karakteristika themelore të ndryshuara („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 46/03), si vijon:

- paragrafët 1 dhe 2 numri „4“ zëvendësohet me numrin „3,9“.
- paragrafi 2 teksti: „Lule - lulëkuqe - Maqedoni“, zëvendësohet me tekstin: „Lule - lulëkuqe - Maqedonia e Veriut“.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

**V. nr. 02-15/V-2/2020  
30 mars, viti 2020  
Shkup**

**Guvernator  
dhe Kryetar  
i Këshillit të Bankës Popullore  
të Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Dr. Anita Angelovska-Bezhoska**